



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 176/2012

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Vlastimir Dimić kryesues, Hasan Shala dhe Ferit Osmani anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), dega në Kaçanik, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), dega në Kaçanik, për shkak të vendosjes së posterave në objekte publike, për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në Komunën e Kaçanikut, në seancën e panelit të mbajtur me 18.06.2012, mori këtë:

VENDIM

Refuzohet si e pabazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 14.06.2012, nga subjekti politik LVV, me të cilën pretendohet se me datën 14 Qershor 2012, në rrugën "Agim Bajrami", në Kaçanik, rreth orës 15:00, pranë urës kryesore të qytetit, të parku, midis Nerodimës dhe murit të Kalasë, militantë të subjektit politik të AAK-së, kanë vendosur posterë të kandidatit të tyre për kryetarë të komunës së Kaçanikut, Tahir Çaka. Parashtruesi i ankesës pretendon se subjekti politik AAK, ka bërë shkelje të Rregullës Zgjedhore Nr.11/2009, neni 3.1 pika (b), si dhe të nenit 33.1 pika (b), të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP).

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur ankesës disa fotografi si dëshmi.

PZAP-i, në kuptim të nenit 4 paragrafi 3 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, e informoi subjektin politik AAK, më datë 15.06.2012, për ankesën që është bërë ndaj këtij subjekti politik dhe ka kërkuar që të përgjigjet ndaj ankesës deri më datë 16.06.2012, në ora 12:00. Sipas afatit të caktuar në shkresën Nr.176/2, PZAP-i, nuk mori përgjigjen e kërkuar nga subjekti politik AAK.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Në ankesën e parashtruar nga subjekti politik LVV, pretendohet se nga militantë të subjektit politik të AAK-së, janë vendosur posterë të kandidatit të tyre për kryetar të

komunës së Kaçanikut, në objekt publik, që gjendet pranë urës kryesore, të parku midis Nerodimës dhe murit të kalasë, PZAP-i gjeti se pretendimet e tilla ankimore nuk qëndrojnë, ngase nga provat e bashkangjitura në ankesë, nuk mund të identifikohet objekti i cili pretendohet se është objekt publik, për arsye se objekti në fjalë nuk përmban ndonjë firmë, për të vërtetuar se për çfarë objekti është fjala, për objekt publik apo privat, prandaj dëshmitë e ofruara, si dhe pretendimet në ankesë u vlerësuan, si të pabazuara, dhe në kuptim të nenit 115.1 lidhur me 118 paragrafi 1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lart përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në Prishtinë

Anr. 176/2012 më datën 18.06.2012.

